



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 181 Prot.

Tiranë, më 23.01.2025

V E N D I M

Nr. 22, Datë 23.01.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 248, Regjistri, datë 27.11.2024, e znj. Xh. D., e cila pretendon diskriminimin e djalit të saj, D. D., nga Shkolla Artistike “Jordan Misja”, Tiranë, për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në dokumentacionin e dërguar, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “*Në cilësinë e prindit të D. D., i cili është nxënës në klasën e 10-të, në Liceun Artistik "Jordan Misja", në degën muzikë, i diagnostikuar me "Aftësi të kufizuar", jam drejtuar pranë Zyrës Vendore Arsimore Tiranë me kërkesën për të mundësuar transferimin e djalit tim nga specialiteti "muzikë" në specialitetin "arte figurative", brenda po të njëjtit institucion. E referova kërkesën time pas një vlerësimi të kujdesshëm të situatës, ku konstatova se:*

- *Fëmija ka shfaqur vështirësi në degën e muzikës, pasi në mjedisin e klasës është përballur me sfida emocionale, duke përjetuar ndjenjën e bullizimit nga disa bashkëmoshatarë, gjë që ka ndikuar negativisht në mirëqenien dhe përfshirjen e tij në procesin mësimor.*
- *Fëmija im ka treguar prirje natyrale për artet figurative, dhe për këtë arsye gjykoj se ky drejtim ofron një hapësirë më të përshtatshme për të zhvilluar kreativitetin dhe potencialin e tij në mënyrë të natyrshme dhe efektive.*

- Përfitimet që ofrohen nga një mjedis më i qetë dhe i sigurt, e motivojnë fëmijën të shprehë veten në mënyrë të lirshme, duke përmirësuar kështu edhe mirëqenien e tij psiko-sociale.

Pas kërkesës time, Zyra Vendore Arsimore Tiranë më është drejtuar me anë të shkresës nr. 8614, datë 12.11.2024, me lëndë “kthim përgjigje”, ku për dijeni është edhe Shkolla Artistike “Jordan Misja”, bën me dije se, bazuar në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të Urdhërit nr. 3, datë 28.01.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, në interesin primar të nxënësit, duhet të ngrihet një komision i specialitetit shkollor brenda shkollës për të bërë ekuivalencat dhe vlerësimin e talenteve nga specialiteti muzikë në specialitetin arte figurative.

Njëkohësisht, Shkolla Artistike “Jordan Misja”, me anë të shkresës nr. 269, datë 14.11.2024, informon Zyrën Arsimore Vendore Tiranë për refuzimin e kërkesës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të lartëpërmendura.

Përsa më sipër, ankuesja kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të djalit të saj, D. D., dhe marrjen e masave për zgjidhjen e shpejtë të problematikës, me qëllim shmangien e pengesave për realizimin e nevojave arsimore, duke siguruar arsimim të barabartë dhe të përshtatur me nevojat e fëmijës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, afhtësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: ““Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata

ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1602/2, datë 05.12.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shkolla Artistike “Jordan Misja”, Zyra Vendore Arsimore Tiranë, DRAP Durrës dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar Tiranë lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Me shkresën nr. 294 prot., datë 16.12.2024¹, Shkolla Artistike “Jordan Misja”, dërgoi informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesja nëpërmjet shkresës nr. 1602/5, është njohur me përgjigjen e Shkollës Artistike “Jordan Misja”.

Në vijim, subjekti ankues, përmes një emaili të datës 21.01.2025, ka kërkuar tërheqjen nga ankesa, pasi ka gjetur një zgjidhje në rrugë private për çështjen e saj.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

¹ Administruar pranë Komisionerit me nr.1602/4 prot., datë 19.11.2024.

Në nenin 94²/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, znj. Xh. D., e cila me anë të kërkesës të përcjellë nëpërmjet emailit të datës 21.01.2025, është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa e paraqitur nga subjekti ankues në datën 21.01.2025, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës Nr. 248, Regjistri, datë 27.11.2024, e shtetases Xh. D., nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës Nr. 248, Regjistri, datë 27.11.2024, të znj. Xh. D., për arsye se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

² “Tërheqja e ankesës”.